

juar shpenzime administrative Komunen e Malishevës", është njoftuar në reagim. "Komuna as që është shqetësuar me faktin që mo-

ndonë është fshehur nga publiku. "Ai ka edhe shkelje të tjera dhe raste të hapura për shkelje ligjore". Sipas

kompetente në përputhje me ligjet në fuqi". Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, të enjten, ka

është shprehur kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, të enjten, ka

© KOHA Ditore

Reagimet publike detyrojnë mbledhjen Këshillit Komunal të Sigurisë

Arian Duriqi

LIPJAN, 16 TETOR – Lipjani e ka mbajtur mbledhjen e katërt të Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi, por që kjo mbledhje është mbajtur vetëm pak kohë pas reagimeve publike që kanë pasuar rreth tejkalimit të afateve ligjore për mbledhjet e KKSJ-së. Para kësaj mbledhjeje të fundit, ndërkaq, për këtë vit Lipjani kishte mbajtur vetëm 3 sosh, e fundit ishte më 23 korrik, ndërsa parashihet që së paku një herë në dy muaj të mbledhet KKSJ-ja për të rumbullakuar numrin prej 6 mbledhjesh brenda një viti kalendarik. Autoritetet komunale, ndërkaq, tashmë e kanë kaluar vetëm mbledhjen e katërt me radhë, derisa numri prej gjashtë të tillave pothuajse është i pamundur të realizohet për faktin se fundi i këtij viti numëron tashmë dy muaj e gjysmë. Ndërkohë që, KKSJ-ja nuk e ka mbajtur as takimin me qytetarë që llogaritet të jetë po ashtu obligativ gjatë një viti. Zyra për informim në Lipjan, ndërkaq, ka njoftuar, të enjten, se KKSJ-ja e përbërë nga përfaqësues të komuniteteve RAE nga Magura, bashkësisive fetare, të bizneseve, policisë lokale, përfaqësuesve të komuniteteve kroate në Janjevë dhe

përfaqësuesve të komunitetit turk ka mbajtur mbledhjen e katërt me radhë.

"Situata e sigurisë në Komunën e Lipjanit është vlerësuar e qetë nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, që njëherësh është kryesuar nga kreu i Lipjanit, Imri Ahmeti. Përveç pikave të tjera të rendit të ditës, KKSJ-ja me theks të veçantë ka diskutuar për pikën e tretë me radhë e që ishte Raporti për gjendjen e sigurisë në Komunën e Lipjanit", thuhet në njoftimin zyrtar që ka lëshuar, Alban Nuredini, zëdhënësi i Lipjanit.

Ndërkohë që, shoqëria civile e ka përshëndetur mbajtjen e mbledhjes dhe ka porositur pushtetin lokal tash e tutje të respektojë afatet ligjore për mbledhjet e tilla. Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në OJQ-në YAHR, ka deklaruar me këtë rast se kjo ishte vetëm mbledhja e katërt, por që nuk përmbush udhëzimin administrativ që parashihet 6 të tilla për një vit.

"Mbledhja e kësaj jave e KKSJ-së është mirë që është mbajtur, ndonëse nevojitet një reagim publik për këtë punë, por sipas hapave më të cilat ka shkruar pushteti lokal rreth mbledhjeve të KKSJ-së, del se nuk do të mund të përmbushë afatin ligjor prej 6 mbledhjesh për një vit,



plus takimin me qytetarë që kërkohet me Udhëzimin Administrativ", ka thënë Krasniqi.

Ndërkohë që opozita e Lipjanit funksionimin e KKSJ-së nuk e sheh me rol të veçantë për faktin se, sipas tyre, ky organ është ngritur nga të pëlqyerit e kreu komunal, Ahmeti.

"Roli i këtij organi në të kaluarën ka qenë mjaft me peshe, si i tillë do

në duhej të ishte edhe tani, mënyra përbërja e tij dhe qasja që është dhënë nga vetë kryetari duhej të tejkalohej afatet ligjore për mbledhjen e tij gjatë në dy vite funksionimin normal", ka vlerësuar Lubomir Krustevci, nënkryetar i PDK-së, Dega e Lipjanit.

© KOHA Ditore